

**STOPP**
häuslicher
Gewalt

Si duhet vepruar në rast dhune në familje?

A e njihni ju këtë?

Personi me të cilin ju jetoni – qoftë ky partner i lidhur në martesë, shok apo i afërm, është bërë i dhunshëm karshi jush, ose ju ka kërcënuar. Bashkëjetesa në këtë mënyrë nuk është më e mundur. Situata për ju është e lidhur me frikë dhe stres. Ju kërkoni një rrugëzgjdhje.

Mbrojtje dhe Siguri

Në rast se ju rriheni në shtëpi atëherë ju mund t'i telefononi numrit **110** të **policiës**, me qëllim për të marrë ndihmë të menjëhershme për shkak të keqtrajttimeve.

Policia ka mundësi, që të dëbojë autorin e veprës nga banesa. Burri duhet të japë çelësat dhe të largohet nga banesa. Deri në 14 ditë atij nuk i lejohet të kthehet përsëri mbrapsh.

Gjatë këtyre 14 ditëve ju keni mundësi, që të mendoni në qetësi, se ç'farë dëshironi të bëni.

Shfrytëzoheni këtë kohë për një bisedë këshillimi!

Këshillë dhe ndihmë

Ne ju informojmë ,mbeshtesim dhe ju shoqërojmë, pavarësisht nëse ju dëshironi të ndaheni nga partneri apo të qëndroni tek ai.

Në rast se ju nuk dini gjermanisht, atëherë lutuni të njohurëve apo shokëve që të telefonojnë tek ne. Me kënaqësi mund të vijë dhe ata me ju në këshillim. Ne ndërmjetësojmë edhe përkthyes për gjuhë të ndryshme.

Ne ju mbështesim, në rast se ju dëshironi të bëni një kërkesë urgjente në gjykatë ,per te ndaluar partnerin ,qe megjithese eshte bashkepronar ne shtepi ,nuk lejohet te hyje brenda. Veç kësaj ju mund të bëni kërkesë për një urdhër mbrojtjeje. Përmes këtij autorit të veprës nuk i lejohet që të kontaktojë me ju, që t'ju bezdisë juve, apo që të qëndrojë në afërsinë tuaj.

Në rast se lejëqëndrimi juaj është i varur nga bashkëshorti juaj, atëherë ju mund të bëni kërkesë për lejëqëndrimin tuaj. Përmes ndarjes me burrin tuaj ju nuk e humbi të drejtën e përbashkët të kujdestarisë dhe nuk e humbni fëmijën tuaj.

Për raste të caktuara ju mund të kërkoni të drejtën e kujdesatarisë që ta keni vetëm ju.

Streha e gruas

Grate mund te vetvendosin ,nese atyre i'u nevojitet mbrojtje. Ato e gjejne mbrojtjen tek Streha e grave.

Tek Streha e grave ato qetesohen dhe planifikojne vazhdimin e jetes se tyre. Grate do te marrin ketu rregullisht biseda keshilluese. Ketu ka gjithashtu dhe ndihme per femijet.

Qendra e gruas

Qendra e gruas nje keshillimore e pavarur,ne ndihme te gruas. Aty sigurohet gjithashtu ndihme per femijet e dhunuar.

Numri i telefonit ne ndihme te gruas



Telefoni për ndihmë qëndron i hapur 24 orë për 365 ditë me rradhë në të gjithë vendin. Aty do të merrni në gjuhë të ndryshme

informacione lidhur me mënyrën e sjelljen në rast dhune në familje.

POLICIA

110

Fletë informative

Dhuna në familje është e dënueshme me Ligj!

Keshilla dhe ndihme ne Qarkun e Reutlingen-nit



Erstberatungsstelle Wohnungsverweis
Landkreis Reutlingen 07121-480-4216
Stadt Reutlingen 07121-9486-0



PUNKTUMplus 07121-9486-0



Stadt Reutlingen

